



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
IDENTITEK SHA

Data 15.06.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim i shkatërrimit dhe evadimit të skrapit të krijuar nga dokumentet biometrike”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 90513000-6
“Shërbime për trajtimin dhe asgjësimin/deponimin e mbeturinave jo të rrezikshme.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 400 080 (një milion e katërqind mijë e tetëdhjetë) lekë (pa TVSH).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ”IdentiTek” SH.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1 Ofertuesi duhet të paraqesë::

- a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DT;*
- b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 të DT;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:



2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licensë në kategorinë **III.2.B (ku të ketë të përfshira kodin 20.01.39 – Plastikë dhe kodin 20.01.01 – Letër dhe karton)**, në emër të personit fizik ose shoqërisë, të rregullta dhe të vlefshme, me objekt veprimtarie për rikuperim, stacion transferimi, grumbullim, transportim dhe ruajtja e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

Argumentimi: Referuar neneve 77 e 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, vleresohet e nevojshme dhe e lidhur me objektin e prokurimit kërkesa për paraqitjen e Lejes dhe Licensës së mësipërme, të cilat garantojnë zbatimin e normave e rregullave të legjislacionit mjedisor, nga subjekte të autorizuara ligjërisht për këtë qëllim.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

- b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) mjet, për transportimin e sigurt të mbetjeve, i cili duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Per sa me sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Shënim 2.1

Operatorët ekonomikë për mjetin që disponon duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, dokumentat që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose me huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

3. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën **1 (një) ambjent, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të shkatërrimit të mbetjeve sipas termave të përcaktuara në shtojcën 8 të DT.**

Shënim 3.1: Për të provuar këtë kriter operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi pikat 2 dhe 3: Referuar neneve 77 e 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, vlerësohet e nevojshme dhe e lidhur me objektin e prokurimit kërkesa për vërtetimin e disponimit të ambjenteve për kryerjen e shërbimit gjithashtu dhe mjeteve dhe pajisjeve teknike, për përmbushjen e procesit të transportit të sigurtë. Transporti i materialeve, vecanërisht nga marrja pranë autoritetit kontraktor e deri pranë operatorit ekonomik (në vend-grirje), por edhe si material për evadim deri në landfill, duhet të kryhet në kushte sigurie mjedisore (plastikë e letër) dhe për shkak të konfidencialitetit e karakterit sensibil të të dhënave të dokumentacionit.

4. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka lidhur një marrëveshje ose kontratë, për depozitim të mbetjeve, ku përfshihen plastikë e letër, me një nga subjektet e trajtimit të mbetjeve ne territor (landfill), të licencuar për këtë qëllim.

Shënim 4.1: Për të provuar këtë kriter operatorët ekonomik duhet të paraqesin Akt-Marrëveshjen ose Kontratën e lidhur me një nga subjektet e sipërcituar.

Argumentimi: Referuar neneve 77 e 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, vleresohet e nevojshme dhe e lidhur me objektin e prokurimit kërkesa për paraqitjen e Lejes dhe Licensës së mësipërme, të cilat garantojnë zbatimin e normave e rregullave të legjislacionit mjedisor, nga subjekte të autorizuar ligjërisht për këtë qëllim. Gjithashtu, Akt-marrëveshja ose Kontrata e kërkuar me një nga subjektet e trajtimit të mbetjeve ne territor (landfill), të licencuar për këtë qëllim, garanton sipas legjislacionit në fuqi se mbetjet do të depozitohen në vendet e caktuara e të lejuara nga oerganet kompetente, dhe trajtimi i tyre do të behet nga subjekte të licensuara në këtë fushë.

5. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që disponon makineri grirëse, me sistem sigurie (imtësi të grirjes) të nivelit **P5** ose ekuivalent, sipas standardit **DIN 66399**.

Shënim 5.1: Për të provuar këtë kriter operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi: Referuar neneve 77 e 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, vleresohet e nevojshme dhe e lidhur me objektin e prokurimit kërkesa për vërtetimin e disponimit të mjeteve dhe pajisjeve teknike, për përmbushjen e procesit të transportit të sigurtë dhe grirjes së materialeve në nivel të përshatshëm sigurie. Makineria/pajisja grirëse, duhet të mundësojë grirjen e dokumentit në pjesë të imëta të nivelit P5 (ose ekuivalent) pikërisht për shkak të kushteve të sigurisë së dokumentit si më lart cituar.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër të ruaj konfidencialitetin e të dhënave, në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Argumentimi pikat 5 dhe 6: Referuar neneve 77 e 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, vleresohet e nevojshme dhe e lidhur me objektin e prokurimit kërkesa për vërtetimin e disponimit të mjeteve dhe pajisjeve teknike, për përmbushjen e procesit të transportit të sigurtë dhe grirjes së materialeve në nivel të përshatshëm sigurie. Transporti i materialeve, vecanërisht nga marrja pranë autoritetit kontraktor e deri pranë operatorit ekonomik (në vend_grirje), por edhe si material për evadim deri në landfill, duhet të kryhet në kushte sigurie mjedisore (plastikë e letër) dhe për shkak të konfidencialitetit e karakterit sensibil të të dhënave të dokumentacionit. Makineria/pajisja grirëse, duhet të mundësojë grirjen e dokumentit në pjesë të imëta të nivelit P5 (ose ekuivalent) pikërisht për shkak të kushteve të sigurisë së dokumentit si më lart cituar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.



Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 29.06.2026 Ora: 12:00.

